

Tiranë, më 04.12.2024

ANKIM

**Apelues:** Jamarbër Malltezi

**Kundër:** Vendimit "Për mosfillimin e procedimit penal, që ka të bëjë me kallëzimin nr. 264, datë 18.11.2024"

**Drejtuar:** Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

**Baza ligjore:** Neni 291 i K.Pr.Penale

I/E nderuar,

Unë kallëzuesi **Jamarbër Malltezi**, më datë 18.11.2024, i jam drejtuar Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me kallëzim penal kundër shtetasve:

- (1) **Edi Rama**, ish kryetar i Bashkisë Tiranë, aktualisht kryeministër i Republikës së Shqipërisë për kryerjen e verave penale "Shpërdorimi i detyrës", "Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës" dhe "Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës" parashikuar nga nenet 248, 320 dhe 321 i Kodit Penal;
- (2) **Taulant Balla**, ministër dhe deputet i Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e verës penale të "Kallzimi i rremë" parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal;
- (3) **Enkeleda Millonai** dhe **Arben Kraja**, prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për kryerjen e veprave penale "Shpërdorimi i detyrës" dhe "Kryerja e veprimeve arbitrare", parashikuar nga nenet 248 dhe 250 të Kodit Penal.

Në materialin e mësipërm, në mënyrë të përmbledhur janë referuar këto fakte penale:

1. *Edi Rama, në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe të KRT të kësaj Bashkie, (1) ndryshoi destinacionin e zones nga sportive ne banim (pa kerkese as te pronareve te tokes dhe as te institucioneve shteterore), qofte me vendimin e KRRT nr. 132 date 08.06.2006 edhe me vendimin e KRRT nr. 238 date 27.12.2008, ne "Zhvillime te reja me parametra te larte urbane", (ii) firmosi;*
2. *Edi Rama me vendimin nr. 136 datë 29.12.2007, miratoi lejen e sheshit te ndërtimit;*
3. *Dy muaj me pas, KRRT e drejtuar nga Edi Rama me 16.02.2008 miratoi lejen e ndërtimit për zhvillimin e tokës në pronësi të familjes Begeja (me kusht privatizimin e objekteve te uzurpuara*

- dhe rrenuara), dhe (iii) pergjate 2008 autorizoi drejtoreshen e tij A. Kushi dhe GIS Kadastra ne varesi te Bashkise qe te caktonin siperfaqet e tokes dhe objekteve qe privatizoheshin;
4. Edi Rama pasi mori dijeni se trashëgimtar i familjes Begeja ishte edhe unë kallëzuesi Jamarbër Malltezi (dhëndri i kundështarit politik të tij Sali Berisha) nuk e ka zbardhur lejen e ndërtimit për hakmarrje politike;
  5. Më pas trashëgimtarët “Begeja” kanë nisur procedurat gjyqësore për detyrimin e të kallëzuarit Edi Rama, të zbardhi vendimin e miratuar nga vetë ai;
  6. Me vendimin Nr. 2433, datë 26.03.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë dhe detyrimin për zbradhjen e lejes së ndërtimit;
  7. Me vendimin Nr. 1297, datë 01.07.2010, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi lënien në fuqi të vendimit Nr. 2433, datë 26.03.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
  8. Pavarësisht se vendimi i Gjykatës së Apelit ishte i formës së prere, Edi Rama përsëri refuzoi të zbardhte lejen duke ushtruar rekurs kundër vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit;
  9. Gjykata e Lartë e RSH (00-2013-1943, datë 27.09.2013)-la në fuqi vendimet e dy gjykatave të shkallëve më të ulta që përcaktonin detyrimin e Edi Ramës për zbradhjen e lejes së ndërtimit të miratuar nga vetë ai duke dëmtuar me faj interesat e trashëgimtarëve “Begeja”, gjë e cila vërteton veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”;
  10. Pas vendimit të Gjykatës së Lartë, dhe fillimit të punimeve, në mënyrë abuzive, Edi Rama lëshoi një **seri aktesh të kundraligjshme** për pengimin e ndërtimit sipas lejes së lëshuar prej tij, konkretisht: a- Vendimi Nr. 428, datë 29.10.2010 të Bashkisë Tiranë, INU - gjobë 500.000 lekë për hapje grope "për ndërtimin e objektit pa leje ndërtimi". b- Vendimi Nr. 127, datë 29.10.2010 të Bashkisë Tiranë, INU - pezullim i punimeve të ndërtimit. c- Vendimi Nr. 5026, datë 28.02.2011 i këtij intitucioni për “prishjen e objektit pa leje ndërtimi”;
  11. Pas vendimeve të mësipërme dhe vijimit të moszbradhjes së lejes trashëgimtarët “Begeja”, u detyruam te padisim në gjykatë Bashkinë Tiranë për dëmin e shkaktuar nga mos-zbradhja e lejes së ndërtimit dhe pengimi i punimeve;
  12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane me vendimin Nr. 2653, dt.06.04.2011 vendosi pranimin e pjesshem te padise. Gjykata u shpreh se kemi te bejme me **“Mosveprim te Kundraligjshem”<sup>1</sup> qe ka rezultuar ne dem** nga ana e Bashkise Tirane dhe detyroi te paditurin Bashkia Tirane qe te demshperbleje paditesin per demin jashtekontraktor ne vleren 34,743,803 leke. (dëmi i shkaktuar shtetit nga i kallëzuar Edi Rama-element i veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”;
  13. Shtetasi Taulant Balla (qe kish kryer shpifje qysh ne 2012) ka kryer kallzim te rreme ne SPAK ne 2020 lidhur me pretendimin e tij sikur toka e familjeve pronare te Tiranes ishte shpronesuar nga Shefqet Verlaci edhe Jako Mane (sic eshte shkruar nga shtetasi Taulant Balla) gjate kohes se okupimit Italian;
  14. Në fletoren zyrtare te kohes ka qënë i pasqyruar fakti se nuk eshte kryer shpronesim per keto toka, por kane gene ne rekuizim te perkohshem ushtarak pa i ndryshuar pronesine (shih Fletore Zyrtare nr. 62, date 15.05.1942 ku eshte botuar Dekreti i Mekembesit nr. 90 date 29.04.1942, dhe Fletore Zyrtare nr. 73, date 30.06.1943 ku eshte botuar Dekreti i Mekembesit nr. 204 date

---

<sup>1</sup> “Mosveprimi i kundraligjshem” ben pjese ne nenin Shperdorim Detyre te Kodit Penal

- 04.06.1943), fakt i pranuar edhe nga ana e prokurorëve të çështjes Millonai dhe Kraja (Në të tilla kushte vërtetohet vepra penale e “Kallëzimit të rremë”, për ministrin Taulant Balla);
15. Prokurorët e procedimit penal nr. 287, të vitit 2020, të kallëzuarit nga ana imë Enkeleda Millonai dhe Arben Kraja edhe pse arritën në konkluzionin se kallëzimi i bërë nga Taulant Balla ishte i rremë, sërish nuk ngritën akuzë kundrejt tij duke konsumuar kështu veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”;
  16. Prokurorët Kraja dhe Millonai në vitin 2022, sekuestruan dosjen civile, ku kisha paditur Taulant Ballen për shpifje, sic konfirmohet nga shkresa nr. 6659/1 date 02.11.2022 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane;
  17. Të gjitha veprimet e mësipërme, janë kallëzuar nga ana ime si veprime arbitrare të prokurorëve Enkeleda Millonai dhe Arben Kraja, veprime të cilat kanë pasojë kufizimin e lirisë time.

Materiali kallëzues së bashku me provat bashkangjitur tij janë regjistruar si “Kallëzimi Penal nr. 264, datë 20.11.2024”. Vetëm 4 (katër) ditë më vonë Prokuroria e Posaçme ka marrë vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal ...”, arsye për të cilën po i drejtohem i me ankim kësaj Gjykate.

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në vendimin e saj në lidhje me veprat penale për të cilat janë kallëzuar shtetasit Edi Rama dhe Taulant Balla shprehet se: “Persa i përket kallëzimit të shtetasit Jamarbër Malltezi ndaj shtetasit Edi Rama dhe ndaj shtetasit Taulant Balla, referuar fashikullit të procedimit penal nr. 287 të vitit 2020, konstatohet se këto pretendime, përfshirë edhe veprat penale të pretenduara se janë konsumuar nga këta shtetas, janë ngritur nga ana e kallëzuesit edhe gjatë fazës së hetimeve paraprake. Duke marrë në konsideratë faktin se procedimi penal nr. 287 i vitit 2020 është dërguar për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe çështja është në seancë paraprake, këto pretendime duhet të trajtohen gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes”.

Në lidhje me dy të kallëzuarit Edi Rama dhe Taulant Balla, Prokuroria e Posaçme mjaftohet vetëm me arsyetimin e mësipërm për të mos kryer asnjë veprim tjetër hetimor, e për të arritur në konkluzionin se nuk duhet të fillohet një procedim penal në ngarkim të tyre. Si fillim në arsyetimin e SPAK, nuk ka asnjë referencë ligjore mbi të cilën mund të arrihet në konkluzionin se nisur nga fakti se kallëzuesi në fazën e hetimeve paraprake të një procedimi tjetër penal ka sqaruar rrethana të ngjashme me ato të kallëzimit, ky kallëzim nuk mund të fillojë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur në kallëzim, veprimet procedurale hetimore të kryera nga vetë organi i akuzës dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet, analizën e provave dhe mënyrën e arritjes në këtë konkluzion. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Pra vendimi i SPAK, për mosfillimin e procedimit është i pa mbështetur në ligj dhe në prova.

Sipas aryetimit të ndjehkur në vendimin e mosfillimit, do të duhej që prokurori ti referonte në rrugë të brendshme administrative gjyqtarit të seancës paraprake të procedimit penal nr. 287, të vitit 2020, kallëzimin në fjalë, pretendimet e ngritura në të dhe faktin se organi i akuzës në lidhje me shtetasit Edi Rama dhe Taulant Balla nuk e ka filluar procedimin penal vetëm për faktin se këto pretendime po gjykohen në një proces tjetër dhe jo për faktin se pas verifikimeve të kryera nuk ka rezultuar se ka ekzistencë të veprës penale. Prokuroria e Posaçme në vendimin e mosfillimit, në fjalinë e fundit të paragrafi të dytë të pikës IV, shprehet se: “...këto pretendime duhet të trajtohen gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes”. Në të tilla kushte rezulton se organi i akuzës afërmendsh po detyron gjykatën që në seancë paraprake të shqyrtojë edhe pretendimet e ngritura në kallëzimin tim. A po paragjykohet vendimmarrja e gjyqtarit të seancës paraprake dhe a kemi këtu ndërhyrje në veprimtarinë e gjyktës në kundërshtim me nenin 145 të Kushtetutës.

Nga ana tjetër në pikën II, të vendimit, SPAK relatton se ka kryer verifikime në lidhje me këtë kallëzim, konkretisht me anë të p-verbalit të datës 21.11.2024, janë marrë kopje të akteve procedurale si më poshtë:

- *Vendim nr. 41, datë 22.02.2023 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë;*
- *Vendim i sekuestrimit të datës 19.09.2022 i Prokurores Enkeleda Millonai, proces verbalet përkatëse si dhe proces verbali për kthimin e sendeve të sekuestruara;*
- *Kopje e njehësuar me origjinalin të kërkesës për dërgimin e çështjes për gjykim të procedimit penal nr. 287 të vitit 2020.*

Nisur nga sa më sipër prokuroria nuk sqaron në asnjë moment se mbi bazën e cilit prej akteve të mësipërm është arritur në konkluzionin se për shtetasit Edi Rama dhe Taulant Balla nuk mund të fillohet procedimi penal sipas kallëzimit. Cilat janë ato rrethana, fakte apo veprime që janë kryer kundrejt këtyre shtetasve në procedimin penal nr. 287 të vitit 2020, në raport me veprat penale të kallëzuara nga unë, që nuk e kanë çuar prokurorinë as në minimumin e dyshimit të arsyeshëm për të kryer veprime hetimore të tjera, përpara se të vendoste mosfillimin e proçedimit.

Prokurorët e Posaçëm të proçedimit nr. 287, të vitit 2020, Enkeleda Millonai dhe Arben Kraja janë pikërisht bashkëtkallëzuarit e tjerë nga ana ime të cilët kanë dijeni për faktet e kallëzuara dhe nëse ata do të kishin marrë veprime gjatë hetimeve paraprake në drejtim të Edi Rama dhe Taulant Balla, normalisht që nuk nuk do të ishin të kallëzuar. Në këtë këndvështrim SPAK, e ka futur kallëzimin penal nr. 264, datë 18.11.2024, në një rreth vicioz duke krijuar një ndërgjyqësi e cila nuk ekziston, ose në minimum nuk ka arritur ta provojë këtë. Në këtë moment procedural i takon kësaj Gjykate të zgjidhë këtë konflikt juridik.

Nga ana tjetër në lidhje arsyetimin e mosfillimit të proçedimit për të kallëzuarit Enkeleda Millonai dhe Arben Kraja, përse mosfillimit kryesisht nga ana e tyre të procedimit penal për Taulant Balla, për veprën penale të “Kallëzimi i rremë” edhe pse vërtetuan se rrethanat e paraqitura në atë kallëzim ishin të rreme (*shpronësimi i tokës*) organi i akuzës bie në kundërshtin vetveten ku

në mënyrë absurde nga njëra ana shprehet se veprimet e kryera nga ana tyre (*prokurorëve Millonai dhe Kraja*) janë veprime të cilat do të kontrollohen nga gjykatat më të larta kur ushtrohet ankim (*shiko prg. e 4 nga fundi i vendimit të mosfillimit*), ndërsa nga tjetër në prg. e 3 nga fundi, shprehet se nuk ka bazë për fillimin e procedimit penal pasi nuk janë konstatuar veprimtari që lidhen me kryerjen/moskryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin.

Sqaroj gjykatën se kallëzimi im nr. 264, datë 18.11.2024, përveç të tjerave sjell në vëmendje mos zbatimin e ligjit material dhe procedural penal nga ana prokurorëve Enkelda Millonai dhe Arben Kraja të cilët edhe pse arritën në konkluzionin se faktet e paraqitura nga Taulant Balla janë të rreme, ky i fundit nuk u mor në përgjegjësi penale. Organi i akuzës ndryshe nga sa ka bërë do të duhej të fokusohet vetëm në këtë fakt të paraqitur në kallëzim dhe jo të merte në shqyrtim vijimin në aspektin procedural të gjykimit të procedimit penal nr. 287, të vitit 2020.

Gjithastu vendimi i SPAK, për mosfillimin e procedimit penal është një vendim i cili në 90% të tij përbëhet vetëm nga relatimi i kallëzimit, akteve dhe doktrinës/jurisprudencës në tërësi dhe jo në raport me kallëzimin që po shqyrtohet nëpërmjet tij.

Nga ana tjetër në vendimin për mosfillimin e procedimit konstatohet se përveç marrjes në administrim të provave të paraqitura nga kallëzuesi dhe disa prej akteve të procedimit penal nr. 287, të vitit 2020, nuk është kryer asnjë veprim hetimor i mëtejshëm, duke mos ushtruar tërësisht funksionet që i njej ligji procedural penal, i cili parashikon se prokuroria duhet të kryejë një hetim të plotë dhe të gjithëanshëm, me qëllim vërtetimin e elementeve të veprës penale dhe vënien para përgjegjësisë të personave që dyshohen si autorë të veprave penale. Me qëllim që prokurori të arrijë të ngrejë akuzë kundër këtyre subjekteve, ai duhet të mbledhë fakte dhe prova me anë të të cilave, në tërësinë e tyre, të mund të arrijë të provojë para gjykatës fajësinë e personit. Nisur nga parimi i ligjshmërisë, prokuroria është e detyruar të hetojë me hollësi dhe të mbledhë prova, nëse ka, lidhur me çdo ngjarje që mund të ketë cilësi të karakterit penal.

Në nenin 1 të K.Pr.Penale, parashikohet se: *“Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit”.*

Ndërkohë, në nenin 2 të K.Pr.Penale, parashikohet se: *“Dispozitat procedurale përcaktojnë rregullat për mënyren e ushtrimit të ndjekjes penale, trajtimit, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.”*

Prokuroria nuk ka bërë një hetim të plotë dhe të gjithëanshëm, pasi në rastin konkret përmbushen të gjitha elementet e kryerjes së veprave penale të parashikuara nga nenet 248, 250, 305, 320 dhe 321 Kodit Penal, si rrjedhojë duhet të kishte bërë regjistrimin dhe fillimin e procedimit

penal në ngarkim të të kallëzuarve. Sa më sipër argumentuam dhe analizuam, organi i akuzës minimalisht duhej të procedonte me disa veprime hetimore për të verifikuar ekzistencën e fakteve të parashtruara në kallëzim dhe sidomos të hetone në drejtim të gjetjes të pasojës së pretenduar nga kallëzuesi (*në rastin e të kallëzuarit Edi Rama*) dhe jo të vendoste mosfillimin e hetimit.

Prokurori i SPAK Maksuti ka bere nje pershkrim te percipite duke shtremberuar edhe faktet per te justifikuar shkeljet ligjore. Keshtu psh ndersa eshte vertetuar se prokuroret Kraja-Millonai shkelen te drejten kushtetuese per proces te rregullt ligjor per Z. Malltezi duke sekuestruar dosjen civile per shpifje ndaj Taulant Balles per me shume sesa 1 vit, nga njera ane shprehet se ceshtja eshte shqyrtuar ne Gjykatën Kushtetuese por ne fakt vendimi i GJK ishte se “nuk ka ardhur brenda afatit 4 mujor” dhe jo se kane shqyrtuar dosje se nuk e kishin fare. Nuk shkoj brenda afatit se (i) nga nenshtrimi politik GJK quajti nisje te afatit daten e shpalljes dhe jo te njoftimit te pales (gje qe eshte gjetur shkelje sistematike nga GJEDNJ) dhe (ii) prisnim te merrnim dosjen pasi nuk kishin lene as fotokopje kur e sekuestruan prokuroret Kraja-Millonai. Ne perpjekje per te justifikuar koleget, i njejti prokuror shkruan se “me urdhrin e dates **02.10.2022** jane kthyer dokumentet dhe dosja e sekuestruar pasqyruar kjo me proces-verbalin e dates **03.10.2023**”. Dmth moren urdhrin sot dhe u kthyen pas 1 viti e 1 dite! Prokurore te ketille e turperojne emrin dhe institucionin ndaj hetimi per prokuroret duhet zhvilluar nga Prokuroria e Tiranës dhe jo i njejti institucion si SPAK qe eshte kapur ne menyre te perseritur ne genjeshtra dhe shtremberim faktesh. Shkresa nr. 4277/1 prot. date 29.06.2023 te Gjykates se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane, shkruan se nuk mund te jape fotokopje te dosjes gjyqsore civile per shpifje pasi “pergjigjen e keni marre me shkresen me nr. 6659/1 prot. date 02.11.2022”, pra vijonte sekuestro e dosjes civile pa lene kopje edhe ne fund te Qershorit 2023 kur une kam derguar ceshtjen prane GJEDNJ ne Strasburg.

Në rastin konkret konstatohet se SPAK nuk ka arsyetuar se pse jemi në kushtet e parashikuara nga neni 290, paragrafi I, gërma "ç". Mos arsyetimi i vendimarrjes e cila është mbështetur mbi këtë dispozitë është absurde dhe alogjike. Kallëzuesi i ka mbështetur dhe provuar pretendimet e tij mbi prova shkresore të depozituara të cilat janë të prekshme dhe të verifikueshme, e minimalisht do të duhet të ishin vlerësuar si në aspektin e përmbajtjes ashtu edhe në atë formal për krijimin e dyshimit të arsyeshëm për ekzistencën e faktit penal.

Vendimi në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih Vendimet nr. 3, datë 19.02.2013; nr. 20, datë 13.04.2012; nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

Kolegjet e Bashkaura në vendimin nr. 2/2013, shprehen se: *"Si subjekte që marrin pjesë në këtë fazë, përveç prokurorit dhe policisë gjyqësore, janë edhe kallëzuesi, si njoftues i veprës penale, e në varësi të rastit, edhe personi të cilit i atribuohet vepra penale",* gjë e cila nuk ka ndodhur në rastin konkret pasi kallëzuesi nuk është thirrur apo pyetur në lidhje me faktet penale të kallëzuara. Në këtë aspekt disa prej veprimeve që duhen ndërmarrë për të arritur në një konkluzion të qartë dhe të saktë janë:

1. Të pyetet kallëzuesi;
2. Të administrohet vendimi Nr. 2433, datë 26.03.2010 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
3. Të administrohet vendimi Nr. 1297, datë 01.07.2010 te Gjykatës së Apelit Tiranë
4. Të administrohet vendimi Nr. 428, datë 29.10.2010 të Bashkisë Tiranë, INU - gjobë 500.000 lekë për hapje grope "për ndërtimin e objektit pa leje ndërtimi".
5. Të administrohet vendimi Nr. 127, datë 29.10.2010 të Bashkisë Tiranë, INU - pezullim i punimeve të ndërtimit.
6. Të administrohet vendimi Nr. 5026, datë 28.02.2011 i këtij institucioni për "prishjen e objektit pa leje ndërtimi".
7. Të administrohet vendimi Nr. 2653, dt.06.04.2011 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane.
8. Të administrohet vendimi Nr. 2698, date 13.12.2011 te Gjykatës së Apelit ne Tirane.
9. Të administrohet Fletore Zyrtare nr. 62, date 15.05.1942 ku është botuar Dekreti i Mekembesit nr. 90 date 29.04.1942.
10. Të administrohet Fletore Zyrtare nr. 73, date 30.06.1943 ku është botuar Dekreti i Mekembesit nr. 204 date 04.06.1943.
11. Të administrohet shkresa nr. 6659/1 prot., date 02.11.2022 te Gjykatës së Shkalles së Pare te Rrethit Gjyqësor Tirane.
12. Të administrohet shkresa nr. 4277/1 prot., date 29.06.2023 te Gjykatës së Shkalles së Pare te Rrethit Gjyqësor Tirane.
13. Te kaloje procedimi penal per shperdorim detyre dhe veprime arbitrare nga prokuroret Kraja & Millonai tek Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë qe te shmanget konflikti i interesit mes prokuroreve te te njejtit institucion

Në Vendimin Unifikues Nr. 2, datë 20.06.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku ndër të tjera theksohet se: *"Në gjykimin e çështjes me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes penale, gjykata shqyrton, jo vetëm bazueshmërinë e kërtimeve të paraqitura nga ana e ankuesit, por edhe kontrollin e ligjshmërisë së këtij vendimi, duke verifikuar nëse nga ana e prokurorit janë respektuar drejt rastet e parashikuara nga ligji lidhur me pushimin e çështjes penale".*

Nisur nga arsyetimi i mësipërm jam i bindur se organ i akuzës ka vendosur mbi kallëzimin pa e njohur dhe studiuar atë. Gjithashtu, ligji vërtet i ka njohur prokurorit atributin e ushtrimit të procedimit penal si dhe të vendosë brenda kriterëve ligjore pushimin e çështjes, por kjo e drejtë nuk ka karakter subjektiv mbasi zbatimi i saj sipas vullnetit të prokurorit jashtë kriterëve ligjore do të cënonte parimin e ligjshmërisë nga i cili udhëhiqet i gjithë procesi penal në të gjitha fazat, përfshi edhe atë të hetimit në të cilin prokurori është organi procedues i ngarkuar me ligj.<sup>2</sup>

Këtu duhet mbajtur parasysh qëndrimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 137, datë 26.10.2011, ku ndër të tjera thuhet: “...26. Prokurori në rastin konkret ka gabuar në të dy aspektet, si përsa i përket hetimit duke zhvilluar një hetim të mangët dhe jo profesional, ashtu edhe përsa i përket pengesës që pretendon për vazhdimin e procedimit duke e paraqitur në planin hipotetik dhe duke i’u referuar vetëm afatit kohor të parashikuar në ligj për ushtrimin e ndjekjes penale të parashikuar nga neni 66 i Kodit Penal. 27. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se mos ushtrimi në përputhje me ligjin i të drejtës së ushtrimit të procedimit penal ka dëmtuar jo vetëm interesin publik për ndjekjen penalisht të autorëve të kryerjes së veprave penale dhe vënien e tyre përpara drejtësisë, por dhe të personit të dëmtuar nga vepra penale.”. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se, vendimi i pushimit të prokurorit mund të cënohet jo vetëm për mungesë të një hetimi të plotë dhe të gjithëanshëm, por edhe për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material, sikurëse ka ndodhur edhe në rastin konkret ku organi i akuzës nuk ka bërë asnjë analizë nëse plotësohen apo jo elementët e ekzistencës së veprave penale të kallëzuara mbi të gjitha për të kallëzuarit Edi Rama dhe Taulant Balla.

Në përfundim, duke vlerësuar se vendimi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është marrë në interpretim dhe zbatim të gabuar të gërmës ç) pikës 1 të nenit 290, mbështetur në pikën 2, të nenit 291 të K.Pr.Penale,

Kërkoj:

1. Prishjen e vendimit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, “Për mosfillimin e procedimit penal, që ka të bëjë me kallëzimin nr. 264, datë 18.11.2024”
2. Urdhërimin e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për të regjistruar procedimin penal ne referim të materialit kallëzues nr. 264, datë 20.11.2024 për shtetasit Edi Rama dhe Taulant Balla.
3. Dërgimin e materialit kallëzues për prokuroret Enkeleda Millonai dhe Arben Kraja në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë që të shmanget konflikti i interesit mes prokuroreve të te njejtit institucion.

Me respekt,  
Prof. Dr. Jamarbër Malltezi



<sup>2</sup> Shiko Vendimin Nr. 196, datë 04.07.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.